

Prishtinë, 28/10/2024

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.10.2024, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR. 24/2024/25 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I.** Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KB Bashkimi¹ për lejimin e regjistrimit të lojtarëve Fis Jashari dhe Besim Bytyqi të regjistrohen për KB MegaSport si lojtar me licencë të dyfishtë jashtë afatit kalimtar.
- II.** Komisioni i garave pas shqyrtimit të kësaj kërkesë e bazuar në Propozicionet e Garave të Ligave të Kategorive të Reja Edicioni 2024/25², REFUZON kërkesën e KB Bashkimi.
- III.** Vendimi hyn në fuqi nga data e publikimit

¹ Fis Jashari dhe besim Bytyqijanë të paraqitur në platformën regjistrohu.club tek Bashkimi U-18.

² Neni 10. Regjistrimi i lojtarëve-eve, e drejta për të luajtur pika 10.3

10.3. Lojtarët/et nën moshën 18 vjeçare të regjistruar/a në një ekip të Superligës (Meshkuj dhe Femra) apo të Ligës së Parë (Meshkuj dhe Femra) mund të paraqiten vetëm në ekipet (e kategorive të reja) zinxhir të të njëjtit ekip.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina


ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me Vendimin Nr. 24/2024-25, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KB Bashkimi për lejimin e regjistrimit të lojtarëve Fis Jashari dhe Besim Bytyqi që janë lojtar të KB Bashkimi në ekipin zingjir të rinjve nën moshën 18 vjeçare të regjistruar për KB MegaSport si lojtar me licencë të dyfishtë jashtë afatit kalimtar.
- (b) Lidhur me kërkesën e KB Bashkimi, nga shkresat e prezantuara shihet se të njëjtit janë nën moshën 18 vjeçare, andaj në përputhje me nenin 10 pika 3 në Propozicionet e Garave të Ligave të Kategorive të Reja Edicioni 2024/25, u refuzua ky regjistrim i lojtarëve Fis Jashari dhe Besim Bytyqi.

Në emër të Komisionit të Garave të FBK-së,

Armend **HAMITI**
Kryetar i Komisionit



Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE:

Në pajtim me *Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2024/2025, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.*



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina